

SAZAN GOLIKU

Tiranë

### KUMTE PËR PAJTIM DHE PAQE NGA LETËRSIA E ANTIKITETIT

Duke shkuar drejt njërës nga rrënjët kryesore të qytetërimit të sotëm - të antikitetit grek e romak - vëren se dukuritë universale njerëzore si kolizionet, luftërat, konfliktet, mosmarrëveshjet mes individëve, grupeve shoqërore, klasave, shteteve, etnive, religjioneve, raportet mes luftës dhe paqes, mes njerëzores dhe jonjerëzores, mes së vjetrës dhe së resë, mes morales dhe amorales janë shoqëruese të pandara të proceseve komplekse në rrugën e zhvillimit historik të njerëzimit. Me të drejtë është thënë se përcaktimi i specifikës së kontradiktave duhet vlerësuar baras me njohjen e shpjegimin e tyre, pra, si rrjedhim, edhe me zgjidhjen e tyre të drejtë ose të padrejtë, të dhunshme ose paqësore, në kohën e duhur ose të vonuar.

Edhe pse në formacione e sisteme ekonomike, shoqërore, ideologjike e politike të ndryshme, bota e antikitetit grek e romak, nëpërmjet letërsisë artistike dhe mendimit filozofik, që kanë rrezatuar me vlerat e tyre në kulturat e letërsisë e shekujve të mëvonshëm, na përcjell një përvojë të lashtë për të vlerësuar, ballafaquar, krahasuar e trajtuar edhe problemet e realitetit bashkëkohor, pra, edhe të atij shqiptar, që ndihmon për zgjidhjen. Dihet se lënda e historisë, por edhe e letërsisë orale e të kultivuar ka për bazë kryesisht luftërat e në përgjithësi konfliktet me armë dhe ato pa armë. Po njëkohësisht, si domosdoshmëri jetike, pas ose gjatë konflikteve ose mosmarrëveshjeve, janë realizuar edhe proceset e paqimit dhe ato të pajtimit, të marrëveshjeve me anë të ndërmjetësimit, takimeve, dy ose shumëpalëshe, këmbimit të robërve e pengjeve, po dhe të dhuratave, si shenja të mirëbesimit ose kompromisit.

Këto procese, në një mënyrë ose në një tjetër, janë pasqyruar në lloje, gjini e zhanre të ndryshme letrare, po dhe si formulime teorike të mendimit filozofik.

Natyrisht në këtë trajtesë nuk mund të shqyrtohet e interpretohet gjithçka që kemi trashëguar nga antikiteti greko-romak, por do të përimtësohen shembujt që i vlerësoj më tipikë e më domethënës.

#### HAKMARRJA – RRUGË PA KTHIM

Gjenia poetike e Homerit, që shpaloset me madhështinë e detit në kryeveprat «Iliada» dhe «Odiseja», krahas luftës, grindjeve, shkatërrimit e vuajtjeve të pafundme njerëzore e mbinjerëzore, nuk mund të linte mënjane

pajtimin e paqtimin në tokë e nëntokë, në det e në qiell dhe mes qiellit e tokës.

«Iliada» nis me fjalën shqipe «mëni» (çka vërteton nënshtratin pella-zgjik të epokës homerike) dhe kjo mëri bëhet strumbullar strukturor e dramatik i kësaj poeme madhështore. Rrethimi i Trojës nga akejtë (grekët) po dështonte sepse Akili, kryetrimi i famshëm, i përkëdheluri i perëndive ishte tërhequr i zemëruar e sedërfyer nga fronti i luftës, sepse Agamemnoni, kryekomandanti i ushtrisë greke i kishte marrë skllaven e bukur, Briseidën. Duhej të vriteshin e të plagoseshin kaq e kaq trima, duhej të ndërhynin shokë e hyjni që të pajtohej Akili me Agamemnonin dhe Akili të reflektohte kështu: «*Besa, o Atrid (Agamemnon) më mirë dalë do t'na kishte / si ty si ue t'u merrshim vesh ndër vedi / kur peshë të dy n'zemër të frytë u ngritëm / me përpi shoqin verbue për një femën!... / M'thotë mendja Akejt' kurr' goje s'do ta heqin / grindjen që patëm unë e ti mes nesh. / Për këtë që ndodhi në harresë ta qesim. / Dhe në pastë lënë ndonjë mbresë hidhërimi / e lyp detyra t'i vemë fre çdo epshi. / Prandaj unë sot po heq dorë nga mënia, / hie s'më ka të rrij gjithnjë idhnueshëm.*» (XIX, 69-85)

Ndërsa «Iliada» nis me një grindje në mes të dy krerëve bashkëvend-das, «Odiseja» gati përfundon me një konflikt të ri pasi Uliksi kthehet në Itakë. Eupiteu kërkon gjakmarrje për mëtuesit e vrarë: «*përndryshe turpi do t'na mbesë gjithmonë, / për faqe t'zezë gjithmonë ne do t'përmendemi. / Në qoftë se s'marrim hak për fëmijët tanë, / e për vëllezërit, ç'kuptim ka jeta? / Për veten time është më mirë të vdes.*» (XXIV, 535-539)

Pra, ai kërkon të ngrejë bashkëqytetarët kundër Uliksit, duke i preku»r në sedër, në moralin e tyre, në ndjenjën e turp-it dhe jo në emër të drejtësisë. Se po të kishte kërkuar drejtësi, atëherë do të kërkonte më së pari shkakun e vrasjes së të birit, çka e bëri pajtuesi i urtë Alitersi, i cili iu drejtua kështu burrave të Itakës: «*Veç nga padrejtësitë që keni bërë / ju ndodhën këto t'zeza e mos qani! / Ju nuk pranuat këshillat të m'i ndiqni / dhe as ato t'Mentorit, bari popujsh, / nuk u munduat t'i mbani bijtë në fre*» (XXIV, 564-568)

Por Alitersin s'e dëgjuan. Ndjenja e dhembjes për humbjen e njeriut të afërt bën që të humbasë arsyeja dhe, si rrjedhim, të kryhen veprime me pasoja edhe më të dhimbshme. «*Të çmendurve u printe Eupiteu; / i ishte ngulur n'mendje që t'ia mirrte / të birit gjakun, por aspak nuk dinte / se shkante në atë rrugë, ku s'kthehet më.*»

Pyetjes së perëndeshës Atena, e cila ka marrë pjesë aktive në aventurat e rrjedhën e ngjarjeve, Zeusi i përgjigjet: «*O bijë, pse pyet tani për këto punë? / A s'ishte ti ajo që e këshillove / Uliksin të hakmerret posa u kthye? ... / Ne do të bëjmë që njerëzit të harrojnë / gjakun e bijve edhe të mbi ta.*» (XXIV, 593-604)

Homeri i urtë me metaforën «të çmendur» përcakton qëndrimin e vet negativ ndaj dukurisë së tërbimit individual e kolektiv. Po a nuk vazhdon deri në ditët tona, dhe sidomos ndër shqiptarët kjo «sëmundje» morale edhe pas tre mijë vjetësh? Nuk është rastësi që Homerit e mbyll veprën, qoftë dhe

me «ndërhyrjen hyjnore» (të Zeusit dhe të Atenës të shndërruar si Mentori), me pajtimin e Uliksit me familjarët me të vrarëve prej tij.

«*Shpejt mes dy palëve u lidh besë me ndihmën / e Atenës, së bijës së vet Zeusit, / që mban mburojë, Palladës që kish marrë / krejt zërin e tiparet e Mentorit.*» (XXIV, 671-674)

Pra, kemi një pajtim nga sipër, nga zotat, po në thelb, nëpërmjet konceptionit thellësisht human të kryepoetit Homer, shprehet dëshira e brendshme e njerëzve për pajtim e paqe.

## PARANDALIMI I SË KEQES DHE PAQJA E VONUAR

Thesaret e ideve që burojnë nga kryeveprat e Homerit janë përpunuar ndër shekuj edhe si mendime filozofike nga etërit e dijes. Ja ç' mesazh na përcjell Platoni për qëndrimin që duhet të mbajë njeriu ndaj «goditjeve të fatit»:

«*Ligji thotë se nuk ka gjë më të bukur se sa ta mbash veten sa më të qetë që të jetë e mundur në një fatkeqësi dhe të mos revoltosh, pasi nuk dihet se ç'ka të mirë e ç'ka të keqe në të tilla fatkeqësi, dhe se nuk fitohet asgjë duke u zemëruar... dhe se ajo që duhet të na vinte në ndihmë në të tilla raste, sa më shpejt që të ishte e mundur, pengohet nga dhembja.*» (Republika, Libri i dhjetë, VI)

Dhe më poshtë vazhdon: «*...duhet që pas goditjeve të fatit të rimerret vetja me anë mjetesh që arsyjeja na mëson se janë më të mirat dhe, nëse pësojmë ndonjë goditje, të mos bëjmë si të vegjëlit që e çojnë dorën te pjesa ku janë vrarë dhe humbasin kohën duke bërtitur; përkundrazi, duhet mësuar shpirti vazhdimisht që të bëjë çmos e të mjekojë sa më parë pjesën e sëmurur, të ngrejë atë që është rrëzuar dhe t'u japë fund qarjeve, duke përdorur mjekimin... Kjo është pjesa më e mirë e vetes sonë që ndjek kështu rrugën e arsyes... Po pjesën që na kujton fatkeqësinë dhe që na shtyn të qahemi dhe që nuk di të ngushëllohet, a nuk kemi për ta quajtur alogjike, të plogësht dhe frikacak?» (Republika, Libri i dhjetë, VI)*

Duke kaluar edhe në Romë në shekullin e parë, p.e.r., Horaci te traktati «Arti poetik» (De arte poetica) e trajton këtë problem edhe brenda parimeve e kërkesave për artin teatror:

«*Ai duhet t'i përkrahë të mirët dhe sinqerisht të këshillohet me ta, / pastaj t'i drejtojë të zemëruarit e t'i qetësojë të frikësuarit; / le të lëvdojë... / drejtësinë, ligjet dhe paqen pranë derës së hapur: / ...që fati t'u kthehet të mjerëve e t'u mungojë kryelartëve.*» (196-201)

Duke kapërcyer gati dhjetë shekuj nga Homeri, vërejmë se kjo frymë urtësie e humanizmi gjen vend edhe tek epopeja madhështore «Eneida» e poetit të madh romak, Virgjilit. Edhe këtu fati dhe roli i hyjnive ndikojnë hapur në zhvillimin e ngjarjeve, por qëndrimi i Eneut përcaktohet nga karakteri i tij kur, pas betejës me latinët, përfaqësuesit e këtyre shkojnë te Eneu fitimtar, i cili u thotë: «*Ndërkaq bash prej qytetit të Laurentit / kishin arritur disa delegatë / me degë ulliri në ballë për të lypur një nder: / t'ua*

*kthente Eneu kufomat e atyre / që kishin mbetur të vrarë aty në fushë, / t'u jepte leje edhe që t'i varrosnin; / t'i thoshin se s'kish me kë të luftonte, / armiku ish thyer, ishte shuar fare; / duhej t'i falte ata që kohë më parë / i kishte quajtur miq dhe aleatë. / Trimi Ene s'ua hedh hiç lutjet poshtë, / ua pranon dhe gjegjet mirësisht / dhe për më tepër shton edhe këto fjalë: / «Po ç'është ky fat i zi, more latinë / që ju katandisi në një luftë të tillë / saqë t'i bënit bisht miqësisë sime? / Ju ma kërkoni paqen për të shuarit / dhe për ata që i fshiu fare lufta; / unë sigurisht do të doja që atë paqe / pa tjetër t'ua jepja dhe të gjallëve.» («Eneida», Libri i njëmbëdhjetë, 158-177)*

Fjalët e Eneut, këtij heroi sa trim, aq dhe të ndjeshëm, përveç keqardhjes së thellë për çka ndodhi, përmbajnë dhe një ide tepër të rëndësishme: Paqja të vendoset para fillimit të luftës dhe pasojave të saj vdektare e shkatërruese. Parandalimi i të keqes është shumë më me vlerë se një paqe e vonuar ose e detyruar nga humbja.

## PARIMI I RACIONALITETIT DHE NDËRMJETËSIMI

Ndërmjetësimin, si mjet të zgjidhjes së një konflikti ose situatë të përkeqësuar e gjejmë te «Iliada», po dhe te «Odiseja», ku Zeusi dërgon Hermesin te Kalipsoja, e cila e kishte kthyer të shumëvuajturin Odise në rob të dashurisë së saj. Por ndërmjetësimi jo gjithëherë është realizuar dhe ia ka arritur qëllimit. Në tragjedinë «Prometeu i mbërthyer» të Eskilit, ku miti i Prometeut, i këtij «shenjtori dhe martiri më fisnik në kalendarin filozofik», siç e ka quajtur K. Marksi, kemi një përvojë domethënëse. A mund të ketë pajtim mes pushtetit dhe individit, mes ligjit dhe «të drejtës njerëzore?» Relativiteti i problemit këtu është i dukshëm. Duhet të pranohet se vlerësimi varet nga pozicioni prej nga e shikojmë. Për pushtetin, që zbaton me përpikmëri urdhrat e Zeusit. Prometeu pa dyshim është fajtor. Ja si i drejtohet ai Vullkanit: «...se stolinë tënde, zjarrin që shkëlqen / e që është mjete për çdo mjeshtëri / vodhi dhe e ndau nëpër njerëzinë. / Për këtë mëkatë duhet të dënohet / drejt nga Perënditë, që të marrë mësim / si t'i përulet mbretërisë së Jovit / dhe të mos kujdeset më për njerëzinë».

Vetë Vullkani, edhe pse është kushëri i Prometeut dhe i vjen keq për fatin e këtij, kundër dëshirës e mbërthen në pranga në shkëmbin e shkretë të Kaukazit. Edhe për Vullkanin ai u ka shpërndarë njerëzve dhurata pa të drejtë. Po dhe për Korin (zakonisht zëdhënësi i mendimit i kolektivitetit, të cili thotë hapur se «nuk e zë në gojë si e bëre fajin», po duke marrë anën e Prometeut kërkon vetëm shpëtimin e tij). Prometeu pohon me krenari se i bëri njerëzit të përbuzin vdekjen, se u futi shpresën në shpirt se u fali njerëzve zjarrin, prej të cilit të mësojnë edhe arte. Ai është i vetëdijshëm se «bëra faj me dashje, nuk e mohoj: unë vetes sime i kam sjellë dëm, për t'i bërë mirë gjithë njerëzisë.» Në këtë situatë e me këto qëndrime të ndryshme, Oqeani, i cili i thotë Prometeut se «unë s'dua tjetër sa të dua ty» dhe «më thuaj ç'ndihmë të të jap e mos thuaj kurrë se ke pasur mik më besnik

*ndaj teje se sa Oqeanin», e ka të vështirë t'i japë këshilla Prometeut. Por megjithatë ai ndërhyr për të ndërmjetësuar mes Zeusit e mikut të tij, edhe pse ky nuk përulet dhe as ligështohet nga fatkeqësitë që i kanë rënë. «A tash do të vete edhe do të përpiqem / të t'liroj, në mundsha, nga këto që vuan: / rri prandaj i qetë, vëri gojës fre. / Ti, njeri i mençëm, si nuk e ditke / se gjuhë e keqe çfarë dënimesh sjell?»*

Kështu i thotë Oqeani, por i prangosuri Prometeu pranon më mirë vuajtjet e tmerrshme e të pafundme se mëshirën e Zeusit. Si mund të shpjegohet «kokëfortësia» dhe hedhja poshtë e çdo ndërhyrjeje? Ngaqë Prometeu ishte i bindur se, sido që të vepronte fati ishte i paracaktuar apo nga besnikëria ndaj idealit të tij njeridashës? Zhvillimi dhe fundi i kësaj tragjedie të famshme na bind për të dytën. Ky titan i mospajtit me tiraninë dhe i vetëflijimit për njerëzimin pranon, sipas mitologjisë, të çlirohet e të pajtohet me perënditë vetëm nga një titan tjetër i së mirës, siç është Herakliu.

Në një rrafsh konkret e realist na shfaqet ideja e ndërhyrjes tek një nga shkrimtarët e guximshëm, jokonformist e mjaft origjinal, Lukiani (120-190 të erës së re). Jo vetëm me fjalë, jo vetëm me këshilla, arsyetime e gjykime të shëndosha, po dhe duke ndërhyrë fizikisht, duke rrezikuar dhe jeten, njerëzit e vërtetë janë bërë shembëlltyra të shkëlqyera të humanizmit edhe në lashtësi. Lukiani në tregimin e tij «Aleksandri ose profeti i rremë» përshkruan me hollësi rrugën e një mashtruesi të rëndomtë që arrin të manipulojë turmat. Ai bëhet simbol i gënjeshtërs kolektive, deri sa arrin të djegë në turrën e druve edhe librin «Tezat kryesore» të filozofit materialist Epikurit. «Nuk e dinte i mallkuari Aleksandër – shkruan Lukiani – se ai libër është burim mirësish të mëdha për njerëzit që u bie në dorë; nuk dinte,- vijon ai, - dhe çfarë paqe, çfarë lirie dhe shpëtim nga tronditjet shpirtërore u sjell ai libër atyre që e lexojnë; ai u largon frikën, fantazmat dhe oguret që na tmerrojnë, po kështu edhe shpresat e kota dhe dëshirat e tepruara; na rrënjos në kokë të vërtetën dhe na spastron mendimet - jo me pishtarë, me nomatisje dhe me profka të tjera si këto, po me fjalën e drejtë, me vërtetësinë dhe çiltërsinë e vet të guximshme.» Nuk dihet, kemi këtu një fakt historik apo një gojëdhënë të trajtuar 1800 vjet më parë nga Lukiani. Rëndësi kanë ide të tilla që mishërojnë luftën e përvetshme të kundërtave, të dritës kundër errësirës, të dijes kundër injorancës, të së vërtetës kundër gënjeshtërs.

Është gjëja më e lehtë të manipulosh, pra t'i tërheqësh për hunde, po dhe t'i frikësosh turmat e paditura e fanatike. Pasi u demaskua me fakte nga një epikurian, mashtruesi Aleksandër «u dha urdhër të pranishmëve ta zinin epikurianin me gurë, duke kërcënuar këta se, në rast të kundërt, edhe ata do të mallkoheshin dhe do të quheshin epikurianë. Atëherë turma filloi të gjuante epikurianin me gurë, por Demonstrati – një njeri i shquar në Pont – që u ndodh rastësisht aty, e mbuloi atë me trupin e vet dhe e shpëtoi atë nga vdekja...»

Ndërhyrja këtu nuk ishte për të bindur turmën për absurditetin e veprimit të saj. Mësimi, se në rrethana e kushte të veçanta veprimi konkret

është domosdoshmërisht i dobishëm, është vërtetuar historikisht në gjithë proceset e mëvonshme në vende e periudha kohore të ndryshme.

Se ç'vlerësim i jepej rolit të ndërmjetësit në konfliktet e luftërat në Greqinë e lashtë, e tregon shembulli që përshkruan Plutarku kur jep një pasqyrë të personalitetit gati mitik të Likurgut. Sipas Plutarkut, Sparta në periudhën e saj të artë, veç të tjerash, «luante rolin e arbitrit midis dy palëve ndërluftuese, paqtonte trazirat, shpesh herë pa rrokur shpatë e mburojë, por vetëm duke çuar një përfaqësues, të cilit i bindeshin që të gjithë pa ngurrim, porsi bletët, që, kur shohin mbretëreshën e tyre, mblidhen tok e radhiten përçark saj. Të tillë shkëlqim pati Sparta për hir të ligjeve dhe të drejtësisë së saj.» (1980:50)

Ndryshe nga mjetet e mënyrat e njohura të ndërmjetësve, po dhe të motiveve për të ndërhyrë mes palëve të armiqësuar, te «Volumnia, nëna e Koriolanit», e Plutarkut (nga vepra «Jetë paralele») kemi një shfrytëzim të dyfishtë, së pari të ndjenjave të ndërsjella nënë-bir dhe, së dyti, të logjikës së dobishme, që gjithsesi është e lidhur dhe rrjedh prej së parës. Me kërkesën e një përfaqësie të grave të Romës (që ishte në prag të shkatërrimit nga rrethimi i uolskëve që komandoheshin nga romaku Koriolan), nëna e Koriolanit, bashkë me nusen dhe fëmijët e tij dhe me gra të tjera shkon në kampin e uolskëve. Fjala e saj drejtuar të birit është një gjedhe si e ligjërit të moralit njerëzor e atdhetar, ashtu dhe të atij retorik: «*O biri im, ti po e sheh vetë dhe e kupton nga veshja e nga fytyra jonë, se në ç'gjendje na ka sjellë ikja jote. Mendohu tashti se sa më të mjera jemi ne nga të gjitha gratë, që kanë ardhur këtu; fati e solli që pamja më e ëmbël të kthehet në një pamje më të tmerrshme për mua, posa që shoh birin tim të mendohet keq dhe të kërcënojë muret e atdheut. Edhe lutjet në perënditë, që janë për të tjerët një lloj ngushëllimi në kohë mjerimesh, edhe këto për ne janë një gjë shumë e vështirë, pse nuk mundemi të kërkojmë nga perënditë edhe fitoren e atdheut, edhe shpëtimin tënd. Sepse është nevojë për gruan tënde e për fëmijët që ose ty të të humbasin, ose atdheun. Sa për mua, nuk do të pres që lufta të vendosë për fatin tim. Në qoftë se nuk do të mund të të bind që të sjellësh në vend të grindjes e të këqijave bashkimin e miqësinë dhe të bëhesh mirëbërës i të dy popujve dhe jo shkatërrues i njerës palë, dije mirë se nuk do të hysh në Romë, para se të shkosh përmbi trupin e vdekur të asaj që i detyron jetën. Nuk dua të arrij atë ditë që të shoh qytetarët të triumfojnë kundër birit tim ose birin tim të triumfojë kundër atdheut të tij. Të kërkoj të shpëtosh atdheun tënd dhe të shkatërrosh uolskët, do të ishte një punë shumë e vështirë, se nuk është gjë e ndershme të zhdukësh qytetarët, po dhe e drejtë nuk është të tradhtosh ata që të kanë dhënë tërë besimin. Kërkojmë, pra, të na shpëtosh nga të këqijat që vuajmë, si ne, si dhe uolskët; këta të fundit, përveç shpëtimit, do të fitojnë edhe një emër, sepse bota do të thotë se këta, megjithëqë ishin më të fortë, pranuan t'ua jepnin romakëve paqen dhe miqësinë. Në qoftë se bëhet ky pajtim, ti do të jesh përgjegjës përpara të dy popujve (romakëve e uolskëve). Me të vërtetë nuk dihet se si do të dalë kjo luftë, po një gjë duket që tashti e sigurt, d.m.th. se, po të dalësh fitues, do të quhesh demon i keq i atdheut, e, po të*

*mundësh miqtë e mirëbërësit, do të thotë se ti u shkaktove këtyre mjerime të mëdha*». Logjika e fortë objektive e nënës fitoi mbi subjektivizmin, që përcaktohej nga vetë pozicioni i Koriolanit. Nëna, me zgjuarsinë e me virtyte të larta morale, kërkon që konflikti të mos zgjidhet në mënyrë të njëanshme, po që të mos dëmtohet asnjëra palë, çka do ta nxirrte të paprekur moralin e të birit dhe njëkohësisht do të ndërpriste një kundërveprim të mundshëm nga ana e uolskëve.

Lidhur me këto situata e qëndrime Karl Popper-i shprehet se «para së gjithash, në analizën tonë të vetë situatës, ne zëvendësojmë përvojat konkrete psikologjike (apo dëshirat, shpresat, prirjet) me elemente situacionale abstrakte e tipike, të tilla si «qëllimet» dhe «dija». Së dyti, është pikë qendrore e analizës së situatës, që për ta «gjallëruar» atë, kemi nevojë të supozojmë jo më shumë se personat ose vepruesit e ndryshëm të përfshirë në të, të veprojnë siç duhet ose në mënyrë të përshtatshme, d.m.th. në pajtim me situatën. Natyrisht, këtu duhet të kujtojnë se situata, siç e përdor unë këtë term, përmban tanimë të gjitha qëllimet e duhura dhe të gjitha njohuritë e vlefshme të nevojshme, sidomos për mjetet e mundshme për realizimin e këtyre qëllimeve. Kështu, - konkludon Popperi, - ka vetëm një ligj gjallërues që hyn në punë - parimi i të vepruarit në përshtatje me situatën... Ai është i njohur në literaturë me emrin «parim i racionalitetit» (1998:349).

#### «TA NXJERRIM PAQEN PËRSËRI NË DRITË»

Perceptimi estetik i realitetit në letërsinë e antikitetit greko-romak ka gjetur mishërim artistik në vepra të të gjitha llojeve, gjinive e zhanreve. Aristofani, babai i komedisë, i ka trajtuar gjerësisht me gjuhën e satirës e të humorit konfliktet dhe problemet e mprehta shoqërore, politike e kulturore të kohës së tij. Është pjesërisht e vërtetë ajo që thotë Aristoteli se «Komedia është imitim i çdo gjëje më të keqe nga ç'është ajo në realitet dhe imiton jo çdo farë vesi, po më tepër ato vese që janë qesharake (qesharakja është pjesë e së shëmtuarës)». Në komeditë e Aristofanit, krahas pasqyrimit të së keqes, zënë vend edhe personazhe që kanë virtyte dhe ndikojnë hapur në shuarjen e konflikteve. Në këtë mënyrë shkrimtarët, siç thotë Horaci «duan të sjellin dobi ose të argëtojnë, ose njëkohësisht të thonë gjëra të këndshme dhe të dobishme për jetën.» (2000:333-334).

Te komedia «Lisistrata» e Aristofanit, nëpërmjet groteskut brilant, paqen e vendosin gratë dhe jo ata që e kanë nisur: politikanët e ushtarakët. Lufta mes Athinës e Spartës po rrëronte të dy këto qytete-shtete dhe aleatët e tyre. Atëhere Lisistrata, kjo grua e zgjuar e trime athinjote, thërret e mbledh në Akropol gratë e gjithë Greqisë. Në këtë situatë tragjike komediografi shtjellon fabulën thellësisht komike që ka për bazë «grevën e seksit». Gratë betohen se nuk do të bashkëjetojnë më burrat e tyre, përderisa ata nuk do t'i japin fund luftës. I dërguari i pushtetit, komisari, u thotë grave: «Po si do jini, moj, kaq të zonjat, / saqë t'u gjeni fundin ngatërre-

*save / që ngjasin me shumicë në çdo vend?». Me një krahasim sa të thjeshtë, aq dhe të goditur Lisistrata i shpjegon idenë e saj: «Siç bëjmë ne me fjetet kur ngatërrohen, /që i kapim – ja, kështu - edhe i ngremë/ me boshtet herë atje herë këtu, / njësoj do ta shpërndajmë këtë luftë / po qe se s'na pengoni, duke nisur / tek njëra pal' e tjetra ambasadorë.» Dhe, duke vazhduar krahasimin me fillin, Lisistrata parashtron mënyrën se si duhet vepruar për të vendosur rendin dhe paqen: «E par' e punës është e domosdoshme, / ashtu si lahet leshi i palarë, / të hiqni ç'qelbësira ka Qyteti. / Rrëmbeni një kopaçe dhe shporrni / të gjithë zemërliqet e intrigantët, / ata që bëjnë klika dhe orvaten / të ngjiten nëpër shkallët e pushtetit; / t'u shkulni lesht' e kokës veç e veç. / Pastaj bashkoni brenda në një shportë / ç'vullnet të mirë kemi të përbashkët / e të përgjithshëm...»*

Pas një sërë peripecish groteske, konflikti mes grave e burrave shkon drejt zgjidhjes fatlume. Të detyruar nga kërkesa për dashuri bashkëshortore, burrat dorëzohen dhe pranojnë paqen. Me një ligjëratë bindëse e qortuese drejtuar athinasve dhe spartanëve, Lisistrata parashtron fakte e argumente pse duhet të pajtohen të dy palët dhe thekson se ato që i bashkojnë janë më të rëndësishme e më të shumta se ato që i ndajnë. Kështu, në këtë komedi të shkëlqyer, ndeshjeve luftarake ua zunë vendin fjalët dhe fjalëve këngët e vallet e paqes e të pajtimit. Kur përfundon së lexuari këtë pjesë teatrore, s'ka se si të mos kujtosh fjalët e Nënë Terezës: «Paqja arrihet me vepra të dashurisë».

Në një rrafsh më të gjerë e më kompleks trajtohet problemi i paqes në komedinë tjetër të Aristofanit, me titull «Paqja». Ideja e luftës për paqe, këtu mishërohet me skena të larmishme sa fantastike, aq dhe reale, po dhe me derivate idesh që e pasurojnë veprën, duke i dhënë forcë rrezatuese deri në ditët tona.

Arti i vërtetë ka edhe vlera utilitare. Këtë e vërteton edhe kjo komedi, e cila u shkrua dhe u luajt në skenë në kohën e luftës mes Athinës dhe Spartës dhe në periudhën kur po bëheshin traktativat për paqe mes palëve ndërluftuese. Siç është dëshmuar që në atë kohë, komedia ndikoi dukshëm në nxitjen e procesit të armëpushimit. Angazhimi i poetit të madh të skenës ndaj paqes e punës, ndaj njeriut si njeri, ndaj mirëqenies e kënaqësive të jetës është tregues i thelbit të tij thellësisht njerëzor.

Paqja, e personifikuar si perëndeshë, është mbyllur në një shpellë nga perëndia i luftës, Marsi. Trigjeu, një bujk athinas, i shqetësuar për fatin e gjithë popullit të tij i drejtohet Zeusit: «...ç'paske ndërmend akoma / që t'i punosh dhe më popullit tonë? Qytetet na i shembe, i rrafshove / s'u ngeli më nishan rrethepërçark!» Dhe me një brumbull ngjitet në qiell dhe ulet para pallatit të Zeusit. Po perënditë, të zemëruara me grekët për shkak të luftërave të pafundme mes tyre, ishin larguar «në thellësitë e qiellit». Trigjeu takohet vetëm me Hermesin, si njëfarë zëdhënësi i Zeusit, i cili i thotë se perënditë

*«Sa herë ata ju kanë dhënë paqe,  
ju kini zgjedhur kurdoherë luftën.»*



Prandaj Marsi ka sjellë një havan që siç thotë Hermesi, «*t'i shtypë e t'i bëjë pluhur fare / dhe ato pak qytete që u ngelën.*» Por lajmet që vijnë nga Greqia për vrasjen e dy kryekomandantëve kundërshtarë, që mishëronin luftën, bëjnë që Marsi të tërhiqet. Shpallja e luftës ka një ose disa shkaqe ekonomike, pra, duhet të ketë një rrjedhojë ekonomike që të kthehet në shkak ekonomik për përfundimin e luftës. Por është e domosdoshme dalja nga skena politike dhe luftarake e forcave ose personave që për interesa të tyre egoiste, morale ose psikologjike këmbëngulin për vazhdimin me çdo kusht të luftës. Pikërisht, vrasja e Kleonit dhe e Brasidës i hap rrugën marrëveshjes për paqe në këtë komedi.

Trigjeu thërret bujqit që të nxjerrin paqen nga shpella: «*Erdhi, o grekë, çasti vendimtar! / Tani që u zhdukën cmiri dhe grindjet / ta nxjerrim Paqen përsëri në dritë, / përpara se të vijë ndonjë shtypës...*»

Mes entuziazmit të papërmbajtur të bujqve nis heqja e gurëve nga gryka e shpellës. «*Ne nuk e lëmë pa mbaruar / këtë detyrë të shkëlqyer*», thërret Trigjeu. Vendosmëria për ta nxjerrë Paqen nga shpella duhet kuptuar si domosdoshmëri që lejon të përdorësh të gjitha mjetet e mënyrat e mundshme. Pra, lufta për të arritur në një marrëveshje dhe si rrjedhojë armëpushimin, d.m.th. paqen, është ndoshta po aq e vështirë sa dhe lufta për të triumfuar kundër armikut.

Guri te shpella e Paqes është simbol i bllokimit të gjendjes. Me forca të bashkuara, njerëzit dhe perënditë: uniteti i tokësore dhe hyjnore, që në një mënyrë tjetër mund të interpretohet si unifikim i materiales dhe shpirtërores, është e vetmja rrugë e mundshme që realizon paqen. Por në procesin e zgjidhjes së konflikteve janë interesat që përcaktojnë qëndrimin e palëve të ndryshme ndaj zbutjes ose acarimit të situatës. Për ata që tërheqin litarët, për të hequr gurët e shpellës, Trigjeu thotë:

«*Vetëm kush mban prej tyre parmendë / po na ndihmon vërtetë me gjithë shpirt, / kurse ata që farkëtojnë armë / përpiqen t'i pengojnë ata të tjerët.*»

Prandaj u drejtohet kështu fshatarëve të Athinës: «*Ju që e keni Paqen shpirt e zemër / tërhiqni trimërisht.*»

Po ç'përfaqëson Jerkoli, falltari luftënxitës? Ai me fraza të sofistikuara kritikon paqen duke e quajtur «të nxituar», që «s'do t'ju dalë për mirë». Me profecitë e tyre për fatin e njerëzve në luftë, falltarët kishin fitime të majme, prandaj ishin kundër paqes. Pra, nuk janë vetëm prodhuesit e tregtarët e armëve kundër (të cilët në komedi vihen kaq bukur në lojë), po dhe gjithë ajo superstrukturë e mashtrimit të turmave, që vepron me sukses sot e kësaj dite. Akuza që Trigjeu i ben Jeroklit: «*E ka thënë fort mirë Homeri i mençur dikur: «Kush ka qejf të këqijat e luftës civile, s'ka familje, as ligj, as shtëpi!»*» përmban një të vërtetë të madhe, tronditëse.

Siç shkruan U. B. Galli në librin «Filozofët e luftës dhe të paqes», E. Kanti «ishte në gjendje ta paraqiste detyrën e vendosjes së paqes së përjetshme, ashtu si të gjitha detyrat e tjera madhore të njerëzimit, kryesisht si një çështje e njeriut për të ribërë vetveten, mjetet e tij të jetesës, banesën, insti-

tucionet, standardet morale dhe shkencore, të konsideruara të gjitha këto si raste të veçanta të së vërtetës, sipas së cilës vetë puna e njerëzimit është njeriu» (1999:46). Këtë ide madhështore, që është kthyer në ideal, e gjejmë të mishëruar në këtë komedi. Si një himn i vërtetë na tingëllon ligjërata e Trigjeut: «*Popuj, dëgjoni! Ç'janë katundarë, / të marrin veglat e të dalin fushës / pa pasur kështu shpata shigjeta, / se Paqja mbretëron sot anembanë! / Të ngremë për fitoren një pean / dhe pastaj kushdo t'i shtrohet punës... / Paqes faljuni, o njerëz, se ajo na ka shpëtuar / nga Gorgonat çnjerëzore dhe nga xhufkat përmbi kokë! / Pastaj merrni mish e meze dhe, o burra, për të shkuar / atje poshtë ku ju presin një shtëpiz' edhe një tokë!»*

Krahas idesë se Paqja kërkon e nxit punën, Aristofani ndriçon dhe idenë tjetër se Paqja sjell bashkimin, ashtu si dhe bashkimi solli Paqen. Në kulmin e vëllazërimit të njerëzve, Hermesi thërret: «*O Neptun, shikoje turmën ç'shëmbëllen plot madhësi / e bashkuar si një trup, tërë gaz si një gosti!»*

Rrjedhën e ideve e të problemeve të shtruara e të shtjelluara me gjuhën e artit të magjishëm satirik të Aristofanit mund ta shikojmë e ta vlerësojmë edhe në aspektin filozofik në këtë sintezë të Erich Fromm-it:

«Paqja, si gjendje e marrëdhënies të qëndrueshme harmonike midis popujve është e mundur vetëm në kushtet kur struktura e zotërimit ia lëshon vendin strukturës së qenies. Vetë mendimi për mundësinë e paqes, në sfondin e luftës së vazhdueshme për zotërim dhe fitim, është iluzion, sepse ai i pengon njerëzit të kuptojnë alternativën e mëposhtme: ose ndryshim rrënjësor të karakterit të vet, ose luftëra të pafundme (2000: 127).

## PAQJA – PASURI E LULE POEZISH

Poezia lirike e antikitetit grek e romak me larminë e pasurinë e temave e motiveve, të cilat përmbajnë ndjenja, mendime, dëshira e ideale thellësisht njerëzore me vlera universale e aktuale, ashtu si epika e dramatika, trajton me përkushtim e natyrshmëri, si realitet e si ëndërr, po dhe me tone moralizuese e didaktike, idenë e harmonisë e të paqimit, të urrejtjes për luftën dhe të dashurisë për paqen. Poetë që nga Hesiodi, Pindari, Bakilidi, Soloni, Fokilidi, Simonidi, Safo etj. e deri tek Horaci, Ovidi, Tibuli, Properci etj. këndojnë me shpirt e mendje kaq të pastër, duke depërtuar në shpirtin dhe ndërgjegjen e çdo njeriu të çdo shekulli dhe epoke. Ajo çka është thellësisht njerëzore hyn natyrshëm në rezonancë me çdo qenie njerëzore.

Për Hesiodin, marrëveshja midis vetë njerëzve është shumë më e mirë se davatë nëpër dyert e gjykatave: «*Këtë herë ne bashkë duhet ta bëjmë pajtimin / me drejtësinë e duhur, që është bija / më e mirë e Zeusit...»*

Ai i kërcënon mbretërit dhe ata që bëjnë drejtësi: «*O ju, sovranë t'pangopur, drejtësinë / ta mbani n'rrugë të drejtë, hiqni nga mendja / dhunën e prapë; njeriu që u sjell të tjerëve / andrralla, ia ka sjellë vetes s'vet...»*

Në «Një këshillë athinasve» Soloni u drejtohet kështu sundimtarëve: «Sundimi i keq s'i sjell tjetër qytetit / veçse të zeza, t'zeza pa mbarim; / ndërsa sundimi i mirë sjell vetëm rregull / e harmoni të përgjithshme dhe t'këqinjtë / i hedh në pranga, zbut dhe egërsimet, / frenon mendjen e madhe, shuan çdo dhunë, / mjerimit ia thanë lulet, drejtësinë / e çalë e bën të drejtë, kryelartësisë / i ve një fre dhe grindjet qytetare / i dërrmon fare, zënieve të përgjakshme / ua pret furinë edhe për hir të tij / urti e rregull njerëzit gëzojnë.» (Lirika antike greke, 1980:57)

Historia jo vetëm i ka vërtetuar këto mesazhe, por na i shtron edhe sot si imperativ për një të ardhme të qytetëruar, më të humanizuar e më demokratike. Këto ide Pindari i trajton si vlera morale e shpirtërore kur u drejtohet të rinjve: «Pra, e mira më e parë patjetër janë veprat e hijshme dhe nami e dyta. Kush i ndeshi e rroku të dyja, më të lartën kurorë ka fituar.» (Lirika greke, 1980: 117)

Poetët e vërtetë e kanë dalluar mirë karakterin e njërës ose tjetrës luftë dhe, ashtu siç kanë kënduar me simpati e krenari dhe i kanë himnizuar luftërat për të mbrojtur atdheun nga pushtuesit, po ashtu kanë stigmatizuar, goditur e mohuar luftërat civile dhe ato për pushtime.

Urrejtja ndaj luftës shfaqet hapur, kur Ksenofani shkruan: «Por lavde meriton ai, kushdo qoftë, që dhe kur pi tregon gjëra fisnike, për shkak se, kur është fjala për virtyte, kujtesën e ka t'freskët dhe s'na flet për luftërat e titanëve e të gjigantëve, as për centaurë, përralla aq të vjetra, dhe nuk na flet për grindjet e mëdha, që s'kanë asfarë dobie.» (1980:f) Ndërsa Properci shpërthen: «Oh, lumi e marrtë atë që veç ndër armë / e mbërthen Febin (d.m.th. poezinë)». Dhe më poshtë lëvdohet: «...solla me vargun tim nga Mali i Muzave / faqe që do t'i lexosh në prehër t'Paqes / o Pegazide (d.m.th. muzë)». (Poetë latinë, 1978:213-214).

Po largohemi nga «hapësirat qiellore» të poezisë së antikitetit grek e romak, duke e mbyllur këtë shkrim me vargjet e shkëlqyera të Bakilidit, ku sintetizohet vlera e jashtëzakonshme e një dukurie jetike, sa dialektike aq dhe metafizike, siç është paqja: «E paqja madhështore i jep njerëzimit / veç pasuri e lule poezish.» (Lirika antike greke, 1980:107)

Si përfundim, do të citoj pa kurrfarë komenti një mendim të dramaturgut bashkëkohor anglez Jonathan Chadwick në një intervistë në «Gazeta Shqiptare» (5.10.2000) për Festivalin Teatror të Butrintit: «Vjetërsia e botës dhe rëndësia e saj për të gjithë ne qëndron në ndihmën që i jepet hapjes e zgjidhjes së konflikteve të botës në perspektivë.»

**BIBLIOGRAFI**

- Homeri, Iliada, Naim Frashëri, Tiranë, 1965  
Homeri, Odiseja, Naim Frashëri, Tiranë, 1976  
Virgjili, Eneida, Toena, Tiranë, 1996  
Eskili, Prometeu i lidhur, Naim Frashëri, Tiranë, 1950  
Platoni, Republika, Phoenix, Tiranë, 1999  
Aristoteli, Poetika, Naim Frashëri, Tiranë, 1961  
Lirika antike greke, Naim Frashëri, Tiranë, 1980  
Proza antike greke, Naim Frashëri, Tiranë, 1974  
Aristofani, Paqja, Naim Frashëri, Tiranë, 1958  
Aristofani, Lysistrata, Naim Frashëri, Tiranë, 1960  
Plutarku, Jetë njerëzish të shquar, Naim Frashëri, Tiranë, 1980  
Horaci, Arti poetik, Buzuku, Prishtinë, 2000  
Lukiani, Vepra të zgjedhura, Naim Frashëri, Tiranë, 1979  
Poetë latinë, Naim Frashëri, Tiranë, 1978  
Erich Fromm: Të kesh apo të jesh, Phoenix, Tiranë, 2000  
W. B. Gallie, Filozofët e luftës e të paqes, Dituria Tiranë, 1999  
K. Popper, Vepra të zgjedhura, (përgatitur nga David W. Miller), Sh.  
L & Afërdita, Tiranë, 2000  
Ralf Dahrendorf, Konflikti shoqëror modern, Dituria, Tiranë, 1997

**SAZAN GOLIKU****Tirana****MESSAGES OF RECONCILIATION AND PEACE  
REFLECTED IN ANCIENT LITERATURE**

The article presents a «gallery tour» of several masterpieces of Greek and Roman ancient literature, such as «The Iliad», «The Odyssey», «The Aeneid», «Prometheus Bound», «Lysistrata», «Peace» etc. being cases in point, also referring to the ideas and thoughts of Plato, Aristotle and Lucretius. It is through them and the works of other prominent authors, such as Plutarch, Horace and Lucian, that meaningful and universally recognizable messages and teachings associated with the indispensability of peace and reconciliation, of agreement and compromise, are conveyed to us all. The author's comments and interpretations on the various topics and motives related to the questions of reconciliation and peace are theoretically supported by quotations from such scholars as Plato, Kant, Popper, Gallie and Dahrendorf. The modern emphasis reflected by the problems handled and resolved within the context of ancient literature, contributes to the accurate, rational, and human comprehension of contemporary political and social phenomena.